

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019



KOMITETI SHETËROR PËR KULTET

RAPORT VJETOR I PUNËS

VITI 2019

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1- KAPITULLI IFAQE 5-8

- ❖ KUADRI LEGJISLATIV I SË DREJTËS SË LIRISË SË FESË E BESIMIT NË SHQIPËRI.
- ❖ KUADRI INSTITUCIONAL FETAR PËR VITIN 2019.
- ❖ KUADRI LIGJOR MBI TË CILIN BAZOHET VEPRIMTARIA E KSHK DHE ORGANIZIMI I TIJ.

2- KAPITULLI IIFAQE 9-13

DREJTIMET KRYESORE PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE GJATË VITIT 2019

- ❖ MARRËDHËNIET ME BASHKËSITË FETARE DHE SHOQATAT ME KARAKTER HUMANITARO - FETAR.
- ❖ MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET QENDRORE DHE PUSHTETIN VENDOR.
- ❖ MARRËDHËNIET ME ORGANIZMA NDERKOMBËTARË DHE HOMOLOGË, PËR ÇËSHTJE TË LIDHURA ME FENË DHE BESIMIN.

3- KAPITULLI IIIFAQE 13-14

PROJEKTI I STUDIMIT:

“MBI MARRËDHËNIET SHTET – FE NË NIVEL LOKAL”

4- KAPITULLI IV

AKTIVITETE TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2019.....FAQE 14-16

5- KAPITULLI V.....FAQE 17-21

BUXHETI PËR VITIN 2019

- ❖ ZËRAT EKONOMIKË DHE REALIZIMET E TYRE.
- ❖ PROKURIMET PËR BLERJET E VOGLA.

KONKLUZIONE

AKRONIME

- **ASHK** – Agjensia Shtetërore e Kadastrës
- **ATP** – Agjensia eTrajtimimit Të Pronave
- **BF** – Bashkësi Fetare
- **KSHK** – Komiteti Shtetëror për Kultet
- **KMSH** – Komuniteti Mysliman iShqipërisë
- **KOASH** – Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë
- **KKSH** – Kisha Katolike në Shqipëri
- **KBB** – Kryegjyshata Botërore Bektashiane
- **VUSH** – Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë
- **MEPJ** – Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- **MSHMS** – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **MASR** – Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- **ASCAL** - Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor i Punës së Komitetit Shtetëror për Kultet (KSHK) hartohet si detyrim ligjor i një institucioni shtetëror, me qëllim treguesin e arritjeve për vitin 2019, por edhe evidentimin e mangësive, shoqëruar me rekomandimet përkatëse për përmirësim. Komiteti Shtetëror për Kultet, i cili mbështet veprimtarinë e tij në legjislacionin në fuqi mbi fenë, në këtë raport, ka marrë parasysh objektivat e parashikuara në strategjitë qeveritare dhe Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2019-2022. Ky dokument ka për qëllim pasqyrimin transparent të të gjithë aktivitetit vjetor institucional dhe të përdorimit të fondeve buxhetore të alokuara, shpërndarë sipas zërave ekonomikë e produkteve. Treguesit e arritjeve të mira të punës së Komitetit, ndonëse shpesh të pamatshëm apo të pallogaritshëm në shifra, perceptohen me rritjen dhe forcimin e raporteve mes shtetit dhe feve të ndryshme në vend. Rritja e ndjeshmërisë ndaj fenomeneve shqetësuese sociale, ngritja e nivelit të bashkëpunimit mes vetë bashkësive fetare dhe mes tyre dhe shtetit, në nivel qendror dhe/apo lokal dhe klima paqësore fetare, përbëjnë elementët indikatorë të angazhimit institucional, në zbatim të politikave qeveritare të lidhura me fenë.

Raporti përbëhet nga disa kapituj. Në kapitullin e parë jepet një informacion i përmbledhur, i shkurtër e i qartë mbi legjislacionin në fuqi lidhur me fenë, mbi panoramën fetare dhe kuadrin institucional fetar në Shqipëri dhe mbi rolin dhe misionin ligjor të Komitetit Shtetëror për Kultet, si i vetmi institucion shtetëror bashkërendues mes shtetit dhe feve. Kapitulli i dytë është një pasqyrë e drejtimeve në të cilat është fokusuar puna e tij, duke reflektuar edhe arritjet apo mangësitë e bashkëpunimit multi – lateral. Vetë natyra e KSHK e pozicionon atë në nivelin e një pike referimi për bashkësitë/organizatat fetare në zgjidhjen e problematikave të çdo lloji, që kanë të bëjnë me shtetin, qoftë ai në nivel qendror apo lokal. Kapitulli i tretë, i përmbahet projektit të ndërmarrë gjatë vitit 2019, për studimin e marrëdhënieve pushtet vendor – fe, që konsiderohet i vlefshëm për sensibilizimin e të dyja palëve në forcimin e bashkëpunimit mes tyre. Aktivitetet kryesore gjejnë pasqyrimin e tyre në kapitullin e katërt. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2019, KSHK ka qenë element aktiv dhe dinamik i këtyre aktiviteteve.

Raporti, në kapitullin e pestë, paraqet një pasqyrë të fondeve buxhetore në dsipozicion të KSHK për vitin 2019, për shpenzimet e tyre konform legjislacionit mbi administratën publike dhe PBA 2019-2022, të hartuar nga institucioni. Me idenë për të qenë transparent, në këtë kapitull detajohen fondet e përdorura sipas zërave ekonomikë, shoqëruar me tabelat dhe grafiqet demonstrative.

Pjesa përmbyllëse e raportit jep konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Ato do të shërbejnë si pikënisje për vitin e ardhshëm, për një thellim të punës, vëmendjes dhe energjive të të gjithë kapacitetit njerëzor të institucionit.

KAPITULLI I

Komiteti Shtetëror për Kultet, si një institucion qendror, në varësi të Kryeministrit, vepron në bazë të VKM-së Nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar dhe, në ushtrimin e detyrës së tij, i nënshtrohet zbatimit të së drejtës kushtetuese të lirisë së fesë e besimit dhe të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, në këtë fushë. Mbarëvajtja e institucionit është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit shumëpalësh me Bashkësitë fetare, OJF me karakter fetar dhe me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor. Gjatë vitit 2019, veprimtaria e KSHK është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani Buxhetor Afatmesëm 2019-2022, ku janë të përcaktuara qartë objektivat, drejtimet, mënyrat e realizimit të tyre, shoqëruar me shpenzimet përkatëse të alokuara. Institucioni është treguar i kujdesshëm që të forcojë klimën e respektit për besimin fetar në vend, si një faktor për fuqizimin e bashkëjetesës fetare tradicionale dhe si vlerësim për kontributin shoqëror - arsimor - shëndetësor të bashkësive dhe organizatave fetare në jetën shqiptare. Me një vëmendje të veçantë në sigurimin e së drejtës së besimit, duke i konsideruar fetë si kontribues dhe partnerë të fuqishëm në përhapjen e vlerave morale dhe zgjidhjen e problematikave sociale, KSHK është angazhuar totalisht për ngritjen e nivelit koordinues mes shtetit dhe feve.

❖ *KUADRI LEGJISLATIV I SË DREJTËS SË LIRISË SË FESË E BESIMIT NË SHQIPËRI*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me nenet 10 dhe 24, garanton të drejtën e lirisë së besimit dhe siguron ndarjen dhe pavarësinë e shtetit nga feja. Në to shprehimisht thuhet:

Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjëherë në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. 3. Shteti njeht barazinë e bashkësive fetare. 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëritjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. 6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Njëkohësisht, ligjet mbështetëse në këtë fushë, rrisin efektivitetin dhe bëhen provë e fuqishme e zbatimit në jetë të këtyre të drejtave. Këtë e dëshmon panorama e larmishme

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

fetare e vendit tonë, ku ndërthuren fe dhe tradita fetare të ndryshme, dhe ku, krahas 5 komuniteteve kryesore fetare, të cilat kanë ratifikuar marrëveshje reciproke me Qeverinë Shqiptare, ushtrojnë misionin e tyre, edhe “besimet e vogla”, të përfaqësuara nga dhjetëra fondacione, organizata apo shoqata.

E drejta e lirisë apo besimit fetar, rrjedh gjithashtu, nga angazhimet në nivel ndërkombëtar, që shteti shqiptar ka pranuar dhe zbatuar. Shqipëria ka ratifikuar 9 traktate ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit krahas pjesëmarrjes dhe rolit të saj aktiv në Këshillin Evropian.

Rezultatet e arritura në këtë drejtim, janë bërë objekt i vlerësimit të lartë nga ana e organizmave ndërkombëtare të interesuar në këtë fushë. Këtë e dëshmojnë deklaratat nga takimet dhe raportet e ndryshme të përfaqësuesve ndërkombëtarë, ku evidencohet roli pozitiv dhe inkurajues i shtetit shqiptar për ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë së fesë apo besimit, dëshmi e të cilës është mungesa, e rasteve të denoncuar të diskriminimit për shkak të përkatësisë fetare apo e problemeve sistematike dhe thelbësore në këtë fushë, edhe gjatë vitit 2019.

Aktualisht, panorama multi – konfesionale shqiptare njih 5 bashkësi fetare tradicionale dhe besime të tjera, relativisht të reja për realitetin tonë, që veprojnë në formën e shoqatave/organizmave me karakter humanitaro – fetar.

❖ **KUADRI INSTITUCIONAL FETAR PËR VITIN 2019**

Bashkësitë fetare si vijon: 1) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, 3) Kisha Katolike në Shqipëri, 4) Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe 5) Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, kanë nënshkruar marrëveshjeve për marrëdhënie të ndërsjella me Këshillin e Ministrave. Këto të fundit që janë ratifikuar në parlament me ligjet përkatëse: Ligji nr. 8902, datë 23/05/2002, Ligji nr. 10056, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10057, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10058, datë 22/01/2009, ligji nr. 10394, datë 10/03/2011, vendosin kornizën ligjore mbi të cilën bazohet raportet mes shtetit dhe bashkësive fetare. Njëkohësisht ligjet e mësipërme, u krijojnë komuniteteve kushtet që të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre të besimit, edukimit fetar, aktiviteteve, shërbesave etj. Katër prej këtyre bashkësive, që prej vitit 2009 asistohen financiarisht nga shteti shqiptar për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve laikë të administratës dhe arsimit, në zbatim të ligjit Nr. 10140, datë 15.05.2009. Për vitin 2019, shuma e akorduar nga Këshilli i Ministrave ishte në masën prej 109.000.000 lekësh, e shpërndarë sipas VKM Nr. 216, datë 17.04.2019.

Krahas bashkësive fetare të sipërpërmendura, në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë të drejtën kushtetuese të lirisë së fesë, edhe të cilësuarat “besime të vogla apo të reja” si: Baha’i, Dëshmitarët e Jehovait, Kisha e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Xhemati Ahmaddya, etj. që veprojnë nëpërmjet shoqatave/ organizatave/ fondacioneve me karakter humanitaro – fetar, të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, në zbatim të ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”.

❖ **KUADRI LIGJOR MBI TË CILIN BAZOHET VEPRIMTARIA E KSHK DHE ORGANIZIMI I TIJ.**

Komiteti Shtetëror për Kultet u krijua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 23.09.1999 , “Për krijimin e KSHK”, si vazhde e Sekretariatit mbi fenë dhe shprehje e qartë e ndjeshmërisë që qeveria shqiptare tregon për rolin e fesë në shoqëri. Vendimi i sipërpërmendur, u pasua me ndryshime në varësinë dhe organikën e KSHK si vijon: me VKM Nr. 128, datë 11.03.2004, me VKM Nr. 666, datë 26.10.2005, me VKM Nr. 777, datë 14.12.2005, me VKM Nr. 344, datë 07.06.2006, me VKM Nr. 186, datë 03.08.2006, me VKM Nr. 602, datë 10.09.2014, pa ndryshuar natyrën e tij si hallkë rregullatore mes Shtetit dhe feve.

Komiteti Shtetëror për Kultet ka si funksion kryesor: “*Realizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare e organizatave shoqërore të çdo lloji, që kanë objekt veprimtarie dhe ndjekin qëllime fetare*”.


Ky institucion synon dhe ka si përparësi të veprimtarisë së vet punën për:

- Zbatimin e detyrimeve kushtetuese;
- Plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë;
- Zbutjen dhe shuarjen e konflikteve që mund të çënojnë harmoninë ndërfaqetare në vend. Përgjegjësitë kryesore të KSHK mund të përmbledhen si vijon:
- Bashkërendimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare.
- Garantimin e lirisë së besimit e për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare në Shqipëri duke qenë asnjëherë në çështjet e besimit dhe duke njohur barazinë e bashkësive fetare dhe respektuar pavarësinë e tyre.
- Shprehjen e mendimit të tij Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, lidhur me planin mësimor, programet dhe tekstet e pjesës joligjore, për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në bashkëpunim me atë institucion, në varësi të ndarjes administrative territoriale, të interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike e fetare.
- Interesimin për ruajtjen e vlerave të objekteve të kultit në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe me komunitetet fetare
- Paraqitjen e konsideratave të tija Ministrisë së Financave, lidhur me hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave me karakter fetar për komunitetet fetare dhe për përjashtimin e tyre nga taksa doganore, në përputhje me ligjet në fuqi.
- Vendosjen dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të tjera e të diasporës, në funksion të promovimit të bashkëjetesës fetare në vend.

ORGANIZIMI I KSHK

Në bazë të VKM –së, Nr. 602 i datës 10/09/2014, Komiteti Shtetëror për Kultet funksionon si një trup i vetëm, në përbërjen e të cilit përfshihen:
1 Kryetar, 5 Anëtarë, 3 Specialistë dhe një punonjës mbështetës.

ORGANIGRAMA



Përveç detyrave të paraqitura në organigramën e mësipërme, Kryetari i KSHK bën ndarje detyrash sipas përgjegjësi dhe nevojave institucionale, në përmbushje të detyrimeve ligjore. Titullari, për shkak të organikës së thjeshtuar, edhe gjatë vitit 2019, ka qenë përgjegjës për ndjekjen e plotësimit të objektivave specifike për secilin punonjës dhe ka bërë vlerësimin e performancës për ta, gjatë gjithë harkut kohor të vitit 2019. Kjo, në zbatim të legjislacionit në fuqi për administratën publike dhe menaxhimin e kontrollin financiar në njësitë qendrore publike. Struktura e thjeshtë organike, krijon kushtet për një kontroll të brendshëm efikas dhe të vazhdueshëm, gjë që ndikon pozitivisht në ritmet e

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

punës së KSHK dhe në mungesën e humbjeve kohore që mund të shkaktojë burokracia brenda institucionit.

KAPITULLI II

DREJTIMET KRYESORE PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE GJATË VITIT 2019

Komiteti Shtetëror për Kultet funksionon në zbatim të të VKM nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar me VKM nr. 128, datë 11.03.2004. Pika 1, që shprehimisht thotë:

“..krijimin e KSHK për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë .., përcakton rolin kryesor të tij.

Viti 2019 ka qenë vit i ri-afirmimit të rolit rregullator të KSHK, mes shtetit dhe organizmave fetarë. Kjo është realizuar duke u udhëhequr nga parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që me nenet 10 dhe 24 garanton të drejtën e lirisë së fesë e besimit dhe nga legjislacioni në fuqi mbi fenë dhe organizmat fetarë. Natyra e aktivitetit institucional bën që puna të zhvillohet në shumë fusha e drejtime, me një bashkëpunim multilateral, si me institucionet shtetërore, në nivel qendror e lokal, ashtu edhe me bashkësitë/shoqatat fetare.

❖ BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL

Për përmbushjen e misionit institucional, si hallkë lidhëse mes shtetit dhe fesë në Republikën e Shqipërisë, KSHK – ja bashkëpunon fuqimisht me institucione të ndryshme shtetërore, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal. Gjatë vitit 2019 këto marrëdhënie janë konkretizuar në rezultate që janë pasqyruar në aktivitete të përbashkëta, në zgjidhje problematikash të bashkësive fetare apo organizatave humanitaro – fetare, në shkëmbime mendimesh e takime të vazhdueshme për projekte të ardhshme. Duke patur parasysh politikat qeveritare për të cilat feja është jo vetëm një transmetues vlerash morale e virtytesh, por edhe një partner i fuqishëm në jetën socio – ekonomike të vendit, institucioni ka intensifikuar përpjekjet e tij për zgjidhjen e drejtë të shqetësimeve, duke u angazhuar plotësisht, herë – herë duke luftuar edhe me burokracinë e aparatit. Në nivel qendror bashkëpunimi ka qenë i frytshëm me:

- **Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.** Kontributi i KSHK ka qenë i konsiderueshëm për të përgatitur e paraqitur raportime të ndryshme pranë organizmave ndërkombëtarë (OSBE, Departamenti Amerikan i Shtetit, etj.), që trajtojnë të drejtat themelore të njeriut, përfshirë atë të besimit fetar. Këto raportime kanë shërbyer si pasqyrë e rolit garantues nga ana e shtetit shqiptar, të ushtrimit të plotë të kësaj të drejte, pa asnjë diskriminim apo privilegj, dhe si mjete promovuese të bashkëzistencës paqësore fetare në vendin tonë. Të tilla mund të përmendim: përfaqësimin nga KSHK në takimin e parë plotësues të Dimensionit Njerëzor (SHDM) me temë; *“Respektimi i parimeve të tolerancës dhe mosdiskriminimit, përfshirë edhe promovimin dhe mbrojtjen lirisë së fesë*

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

ose besimit”, kontributin në takimin e radhës së HDIM me temë: “*Toleranca dhe mosdiskriminimi*”, konsultimet me Ambasadorin për lirinë fetare në botë, në DASH, z. Sam Brownback, etj.

- **Agjensinë e Sigurisë së Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)** për liçencimin dhe akreditimin e programeve të studimit në Shkencat Islame të Kolegjit Universitar “ Bedër”, në zbatim të kreut IV, neni 35, të Ligjit nr. 80/2015, “ Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, që i shërben përgatitjes së kuadrove të rinj teologë, në vendin tonë. Interpretimi i drejtë ligjor dhe paraqitja e argumenteve bindëse ligjore, janë faktorë determinues në marrjen e vendimeve.

- **Agjensinë Shtetërore të Kadastrës** për propozime ligjore lidhur me procesin e ndërlikuar të kthimit të pronave të bashkësive fetare. Në fokus, kanë qenë objektet e kultit dhe sipërfaqeve funksionale të tyre , të viteve përpara 1990-s dhe për të cilat, nuk disponohen tituj pronësie. Bashkëpunimi vazhdon për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme optimale, me qëllim forcimin ekonomik të bashkësive fetare, në përmbushjen e plotë të misionit të tyre.

- **Institucionet e ndryshme shtetërore të cilat trajtojnë çështje të sigurisë kombëtare dhe të luftës kundër ekstremizimit të dhunshëm dhe terrorizmit**, duke qenë se KSHK është pjesë e strategjive qeveritare për parandalimin e shfaqjeve radikalo – ekstremiste me bazë fetare. Pjesëmarrja dhe kontributi në takime, tavolina diskutuese, trajnime etj., janë dëshmi e këtij rrjeti bashkëpunues që ka qëllim rritjen e ndjeshmërisë ndaj këtij fenomeni shqetësues për sigurinë në shkallë kombëtare, rajonale e botërore.

- **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.** Lidhur me përpilimin dhe zbatimin e akteve normative bazuar në ligjin Nr. 10140, datë 15.05.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” dhe me nevojat institucionale të hartimit të Planit Buxhetor Afatmesëm 2019-2022, të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të programeve/sistemeve të reja për institucionet buxhetore, të raportimeve të ndryshme, etj. Kontaktet dhe bashkëpunimi me drejtoritë e ndryshme në këtë ministri, edhe në forma trajnimesh, kanë qenë të vazhdueshme dhe të frytshme.

- **Pushtetin Vendor.** Duke konsideruar organizmat fetarë si partnerë të fuqishëm në parandalimin dhe zgjidhjen e plagëve sociale, gjatë 2019, KSHK i ka kushtuar një vëmendje të posaçme mbarëvajtjes së relatave mes shtetit dhe feve, në nivel lokal. Në këtë proces është synuar sigurimi i shtrirjes besimore dhe mbështetja për misionin humanitar të organizmave, larg diskriminimeve apo privilegjeve, në të gjithë territorin e vendit. Ideja ka qenë vlerësimi i nivelit të marrëdhënieve mes pushtetit vendor dhe përfaqësuesve fetarë lokalë, për të rritur klimën e bashkëpunimit në të mirë të zonës. KSHK, për këtë qëllim dhe konsideruar si hallkë e shtetit që është garantues i kësaj të drejte dhe asnjans e i barabartë ndaj bashkësive fetare, ka ndërmarrë projektin e posaçëm për të cilin flitet më tej në raport. Nga takimet e shumta ka rezultuar që shpesh këto marrëdhënie mbeten në një nivel kortezie, pa u thelluar më tej. Ka patur edhe raste kur indiferenca, apo influenza e një komuniteti fetar lokal mbi pushtetin vendor ka ndikuar negativisht në aktivitetin e komuniteteve të tjera, duke u konsideruar prej këtyre të fundit, si mohim i të drejtës së besimit. Faktori fetar konsiderohet i një vlere të veçantë kontributive dhe sigurie, sidomos

në zonat rurale, prandaj KSHK është mobilizuar të jetë sa më afër tyre, pavarësisht mundësive njerëzore dhe materiale të kufizuara. Këtë e dëshmojnë edhe pjesëmarrja në veprimtaritë e organizuara në rrethe të ndryshme, të cilat pasqyrohen më gjerë në tabelën përkatëse të aktiviteteve.

❖ **BASHKËPUNIMI ME BASHKËSITË/ORGANIZATAT FETARE**

Qeveria shqiptare çmon misionin e bashkësive fetare si përhapës të virtyteve dhe vlerave të shëndosha morale, por në të njëjtën kohë vlerëson kontributin e tyre shoqëror në parandalimin, sensibilizimin dhe zgjidhjen e plagëve sociale. Parë në këtë këndvështrim, objektivi i KSHK, në marrëdhëniet me BF mund të përmblihet si mëposhtë:

Thellimi dhe forcimi i bashkëpunimit me Bashkësitë Fetare dhe zgjidhja e problematikave shqetësuese që kanë të bëjnë me ushtrimin e misionit të tyre në vend, për të krijuar kushtet optimale të shprehjes së të drejtës kushtetuese së lirisë së fesë e besimit.

Për realizimin e këtij objektivi, KSHK është mobilizuar në harkun e gjithë vitit, për të siguruar të drejtën kushtetuese të lirisë së besimit dhe fesë, në zbatim të direktivave qeveritare në këtë fushë.

Drejtimet kryesore në këtë drejtim kanë qenë:

a) Adresimi dhe zgjidhja e problematikave me karakter ligjoro – administrativ, në të cilën mund të përfshihen aktet apo propozimet ligjore/nënligjore për forcimin e rolit të BF në sferën shoqërore shqiptare dhe krijimi i lehtësirave fiskale për ushtrimin optimal të misionit të tyre. Spektri i këtyre problematikave është shumë i gjerë duke filluar nga ato tarifare/taksore deri tek më të ndërlikuarat që kanë të bëjnë me të drejtën mbi pronësinë. Komiteti i ka adresuar dhe kanalizuar të gjitha kërkesat/ankesat e paraqitura pranë tij dhe është përpjekur fuqimisht të finalizojë në zgjidhjen e tyre, konform legjislacionit në fuqi. Rastet e pazgjidhura, përbëjnë sfida për institucionin dhe shtytje për përmirësim.

Gjatë vitit 2019 janë paraqitur disa ankesa lidhur me moszbatimin e të drejtës për të mos paguar taksa doganore, lidhur me mallrat e dhuruara që përdoren në funksion të aktivitetit humanitaro –fetar të shoqatave jofitimprurëse. Legjislacioni në fuqi, ndonjëherë lë hapësirë për interpretime të bazuara në subjektivizma, duke krijuar shqetësime dhe rënduar aspektin financiar të organizatave. KSHK, në zbatim të ligjit, ka ndërhyrë për kthimin e së drejtës ligjore këtyre të fundit.

b) Adresimi dhe zgjidhja e problematikave me karakter fetar, e cila kërkon një trajtim të veçantë, delikat dhe të pjekur, për të ruajtur ekuilibrat mes BF, në respekt të pozicionit asnjans të shtetit dhe në zbatim të detyrës për forcimin e bashkëjetesës paqësore fetare shqiptare.

c) Bashkëpunimi në shërbim të të mirës së përbashkët, për zgjidhjen e plagëve sociale dhe për promovimin e bashkëjetesës tradicionale fetare në Shqipëri e jashtë saj, e cila përmbledh thelbin e misionit të feve të ndryshme, por edhe një nga objektivat kryesorë të KSHK. Neni 10 që sanksionon ndarjen e shtetit nga feja, nuk përjashton bashkëpunimin e ngushtë për të mirën e shoqërisë, prandaj edhe qëllimi i KSHK, si

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

institucion shtetëror, është ngritja e urave të bashkëpunimit me BF dhe nxitja e atij mes tyre. Iniciativat në këtë drejtim, gjatë vitit 2019 kanë përfshirë aktivitete të përbashkëta, të cilat përmenden në kapitullin e posaçëm të këtij raporti¹.

❖ BASHKËPUNIMI ME HOMOLOGËT, PËRFAQËSITË DHE ORGANIZMAT E HUAJA

Një nga aspektet me kuadër të shëndoshë dhe solid legjislativ në vendin tonë, lidhet me liritë e ndërgjegjes, fesë apo besimit fetar. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet neneve 10,18 dhe 24, njeh dhe garanton këto të drejta, qoftë individualisht apo dhe institucionalisht.

E drejta e lirisë apo besimit fetar, rrjedh gjithashtu nga angazhimet në nivel ndërkombëtar, që shteti shqiptar ka pranuar dhe zbatuar. Shqipëria ka ratifikuar 9 traktate ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit dhe pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të saj në Këshillin Evropian.

Aderimi në OSBE, si një nga organizmat kyç për trajtimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, është realizuar gjatë punimeve të Këshillit Ministror të Berlinit në qershor 1991. Vendi ynë nënshkroi Aktin Final të Helsinkit më 16 shtator 1991 dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re më 17 shtator 1991. Ky aderim shënoi një ndryshim rrënjësor të kursit të politikës së jashtme shqiptare, që do ta çonte në daljen nga vetë-izolimi ndërkombëtar, në afrimin me bashkësinë euro-atlantike dhe në pranimin e vlerave perëndimore të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Aderimi i Shqipërisë u shoqërua me ndërmarrjen e reformave ligjore për respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit. OSBE ka misione në të gjitha vendet Ballkanit Perëndimor, të cilat veprojnë në përputhje me mandatet përkatëse të miratuara nga Këshilli i Përhershëm, organi kryesor vendimmarrës i OSBE-së, ku marrin pjesë ambasadorët e 57 vendeve pjesëmarrëse në Organizatë. Shqipëria punon që veprimtaritë e këtyre misioneve të jenë efektive dhe t'i shërbejnë paqes, stabilitetit dhe integritetit evropian të rajonit. Vendi ynë bashkëpunon ngushtë edhe me institucionet e OSBE-së, si ODIHR dhe Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Shtypit. Viti 2019 ka shënuar vitin e përgatitjes së terrenit, për marrjen e drejtimit të OSBE nga Shqipëria në 2020.

KSHK-ja, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të marra nga shteti shqiptar, ka qenë aktiv në trajtimin e temës së lirisë së fesë dhe besimit, nëpërmjet raportimeve të paraqitura në sesionet e SHDM - OSBE, në Vjenë, në prill 2019, në shtator 2019 në Varshavë, etj. Në to u paraqit realisht angazhimi total i shtetit shqiptar në respektimin e këtyre të drejtave themelore dhe masat e marra për ruajtjen e traditës shekullore të bashkëjetesës dhe dialogut ndërfaqetar. Tema e modelit shqiptar të bashkekzistencës fetare është trajtuar gjerësisht në shumë në takime, bisedime, aktivitete, programe, konferenca, etj. në nivel ndërkombëtar. Rëndësia e fesë në ditët e sotme, parë nën dritën e flukseve migratore, bën të nevojshme shpërndarjen e shembujve pozitivë. Nëpunës të lartë që trajtojnë çështjet e lirisë së fesë në Departamentin Amerikan të Shtetit, përfaqësues të

¹ Paraqitur në tabelën nr. 1 të aktiviteteve.

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

ambasadave të ndryshme të akredituara në Tiranë, etj, në takimet pe KSHK janë interesuar të njohin më thellësisht modelin e veçantë të bashkëpunimit mes feve për ta marrë si shembull dhe, njëkohësisht kanë nxitur KSHK- në për zgjidhjen e problematikave të lidhura me pronat e bashkësive fetare.

Një nga detyrat ligjore të KSHK –së, sipas VKM –së nr. 459, datë 23.09.1999, është: “Vendos dhe zhvillon lidhje me institucionet homologe, të vendeve të tjera e të diasporës”. Në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar bashkëpunimi me Komisionin për Marrëdhëniet me Komunitetet Fetare dhe Grupet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, finalizuar me vizitën e tyre në Tiranë në nëntor 2019. Qëllimi i angazhimit dypalësh është krijimi i një rrjeti rajonal homologësh për të shkëmbyer eksperiencë dhe shembuj pozitivë, kundër diskriminimit me bazë fetare dhe rritjes së sigurisë rajonale.

KAPITULLI III

PROJEKTI I STUDIMIT: “MBI MARRËDHËNIET SHTET – FE NË NIVEL LOKAL”

Projekti studimor me temë: “Marrëdhëniet shtet – fe në nivel lokal”, u ndërmorr me iniciativën e Komitetit Shtetëror për Kultet, nisur nga indiciet e mbledhura në takimet e shumta me përfaqësues të ndryshëm lokalë. Një studim i tillë që bëhet për herë të parë në vendin tonë, drejtohet nga një institucion shtetëror dhe synon të pasqyrojë gjendjen aktuale të marrëdhënieve, pa asnjë influencë me karakter politik apo fetar. Parë në këndvështrimin e menaxhimit territorial, qëllimi i këtij projekti është krijimi (aty ku nuk ekziston), nxitja dhe forcimi i bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm shoqërorë, qofshin ata shtetërorë apo fetarë, për zgjidhjen e plagëve sociale, për mbështetjen e të rinjve në nismat për një perspektivë optimiste jete, për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike të bashkëjetesës fetare. Në këtë projekt, ku protagonistë janë përfaqësuesit e sipërpërmendur, pasqyrohen problematikat me të cilat përballen ata në realitetin lokal, përcillen shqetësimet dhe dëshirat për një përmirësim të situatës ndërrelacionale. Përveç kësaj, ky projekt reflekton shkallën e njohurive legjislativë dhe informacionit në fushën e fesë, si nga përfaqësuesit shtetërorë, ashtu edhe nga ata fetarë, me qëllimin final të mirëinformimit të tyre. Kjo për të siguruar e garantuar ushtrimin e së drejtës së fesë e besimit, si një e drejtë universale, themelore, njerëzore.

Projekti është parashikuar të shtrihet në një periudhë kohore trivjeçare (2019-2021), me një shtrirje territoriale që mbulon të gjithë vendin, por të ndarë në tri zona gjeografike: 1) Shqipërinë e Veriut (viti 2019), 2) Shqipërinë e Jugut (viti 2020) dhe 3) Shqipërinë e Mesme (viti 2021). Kjo ndarje gjeografike dhe kohore është kushtëzuar nga shtrirja e madhe territoriale dhe nga dëshira për t’u thelluar në marrjen e informacionit. Ai është ndarë në tre faza: a) faza përgatitore e pyetsorëve, nëpërmjet të cilëve synohet të merret informacion sa më i besueshëm dhe realistik; b) faza në terren, që përfshin takimet dhe intervistat me përfaqësues lokalë laikë dhe fetarë; c) faza përfundimtare, e analizimit të të dhënave, nxjerrjes së konkluzioneve dhe dhënies së rekomandimeve. Projekti është zhvilluar nëpërmjet një rrjeti kapilar, që ka përfshirë ndarjet administrative nga më të mëdhatë (qarqet, bashkitë, prefekturat) tek më të voglat (njësitë administrative, etj.), për të

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

patur një pasqyrë reale të marrëdhënieve shtet – fe në nivel lokal. Gjatë këtij viti projekti mbuloi gjeografikisht pjesën veriore të territorit shqiptar, duke përfshirë qarqet: Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë me 15 bashkitë përkatëse dhe shumë njësi administrative. Marrja e informacionit është realizuar nëpërmjet intervistave direkte, “face - to – face”, të strukturuar dhe semi - strukturuar, bazuar në pyetsorë të përgatitur paraprakisht me rigorozitet nga staffi i Komitetit Shtetëror për Kultet. Nëpërmjet materialit të mbledhur rezultoi se ka mungesë njohurish legislative në fushën e fesë nga të gjitha palët, ekziston një nivel i kënaqshëm bashkëpunimi në nivel lokal mes aktorëve të ndryshëm, por që nganjëherë kufizohet në nivel “kordial”. Për këtë arsye KSHK do të mobilizohet të jetë më e pranishme në këto nivele, duke u mbështetur në burimet lokale si pika referimi. Qëllimi final është rritja e njohurive të aktorëve lokalë me legjislacionin në fuqi mbi fenë, ndërgjegjësimi i qeverisjes lokale mbi rolin kontributiv të bashkësive/shoqatave fetare dhe nxitja e bashkëpunimit nëpërmjet dhënies jetë projekteve konkrete për përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e komuniteteve lokale, rritjen e qëndrueshmërisë së tyre dhe shërimin e plagëve sociale.

KAPITULLI IV

AKTIVITETE TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2019

Në VKM –në Nr. 459, datë 23.09.1999, një nga detyrat e Komitetit Shtetëror për Kultet cilësohet: *“... Ndiemon dhe mbështet veprimtaritë e mirëfillta fetare bazuar në Kushtetutën dhe në ligjet përkatëse, që rregullojnë problemet konkrete” dhe ...punon për garantimin e lirisë së besimit dhe për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare në Shqipëri”.*

Përveç përbushjes së rolit institucional, pjesëmarrja aktive ka qenë një faktor moral duke patur parasysh se në to trajtohen tema të rëndësishme mbi efektin e feve në jetën arsimore, shoqërore, shëndetësore, në zgjidhjen dhe parandalimin e plagëve të ndryshme sociale shqiptare apo në kontributin historik dhe aktual të tyre në vend.

Qëllimi i pjesëmarrjes dhe kontributit institucional mund të përmblihet në:

- Garantimin e të drejtës kushtetuese të lirisë së besimit dhe fesë, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që çojnë në zbatimin rigoroz të kësaj të drejte, në respekt të konventave evropiane dhe ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria shqiptare, për këtë temë.
- Promovimin e bashkëjetesës tradicionale fetare në Shqipëri si: seminare, trajnime, konferenca, forume, brenda dhe jashtë vendit, ku përcillet fryma e bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe fetare, në të mirë të shoqërisë shqiptare.
- Mbështetje konkrete në iniciativat e komuniteteve lokale për parandalimin dhe shërimin e plagëve sociale.

Aktivitetet më domethënëse paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

Tabela Nr. 1

Aktiviteti	Data	Tema	Problematika
Leximi i Mesazhit të Papa Françeskut	Janar	“Politika e mirë në shërbim të paqes”	Detyrat dhe sfidat për një politikë të ndershme
Konferencë e organizuar nga KU “Bedër”	Janar	“Roli i gruas në shoqëri”	Forcimi i kontributit të gruas myslimane në shoqëri larg diskriminimeve
Asambleja e VUSH	Mars	Analiza vjetore dhe sfidat e kësaj bashkësie	Forcimi i bashkëpunimit me shtetin në të mirë të shoqërisë
Simpozium i organizuar nga KBB	Mars	“Bektashizmi në Ballkan, traditat e djeshme dhe sfidat e sotme”	Ruajtja e vlerave të pastra morale të bektashizmit nga ndikimet
Konferencë SHDM - OSBE	Prill	“Respektimi i parimeve të tolerancës dhe mosdiskriminimit, përfshirë edhe promovimin dhe mbrojtjen lirisë së fesë ose besimit”	Garantimi i së drejtës themelore të fesë, pa dallim, privilegj apo diskriminim dhe shembulli shqiptar
Konferencë e organizuar nga ICID	Maj	“Feja në shoqëri; Modeli shqiptar”	Sfidat me të cilat përballen fetë dhe bashkëpunimi mes tyre për ruajtjen e traditës së bashkëjetesës fetare
Takim i organizuar nga IFIT	Maj	“Roli i KSHK, si bashkërendues mes shtetit dhe feve”	Qëllimi i krijimit të institucionit dhe sfidat e tij të vazhdueshme
Konferencë e organizuar nga KU “ Bedër”	Maj	“Instituti për lirinë e besimit dhe demokracinë”	Garantimi i lirive themelore të njeriut në sistemet demokratike
Angazhime në iftarë të ndryshëm	Maj - Qershor	Muaji i Shenjtë i Ramazanit për besimtarët myslimanë	Respektimi i traditave dhe normave fetare dhe mesazhet e solidaritetit

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

Trajnim i organizuar nga UNICRI në bashkëpunim me qendrën për CVE	Qershor	Praktikat e mira të Hagës të Forumit Botëror të Kundër-Terrorizmit (GCTF) mbi lidhjen midis Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Terrorizmit	Ndërgjegjësimi i të gjithë aktorëve për parandalimin e këtij fenomeni
Pjesëmarrje në pelegrinazhin e Malit të Tomorrit	Gusht	Homazh figurës së Abaz Aliut	Respektimi i traditave dhe normave fetare dhe mesazhet e sakrificës që përcjellin
Tavolinë e rrumbullakët me përfaqësues të ODHIR	Tetor	Shembujt dhe praktikat e mira për parandalimin e diskriminimit në fushën e të drejtave të njeriut	Garantimi i të drejtave themelore të njeriut dhe institucionet përkatëse për zbatimin e legjislacionit
Tavolinë e rrumbullakët e organizuar nga KU “Bedër” në bashkëpunim me amb. USA	Nëntor	Angazhimi i të rinjve në qëndrueshmërinë e komuniteteve	Përgatitja me njohuri të duhura për rritjen e qëndrësës ndaj ndikimeve ekstremiste
Konferencë rajonale e organizuar nga Presidenti i RSH në bashkëpunim me DASH	Nëntor	“Feja, si një instrument për paqen”	Shembulli pozitiv i Shqipërisë në sfidat lidhur me fenë, me të cilat përballet njerëzimi
Konferencë e organizuar nga Urdhëri Françeskan (KKSH)	Nëntor	“ Islami dhe krishtërimi, ndërmjet historisë dhe perspektivave”	Përkujtim i 800 Vjetorit të takimit mes Shën françeskut dhe Sulltanit, për të theksuar rëndësinë e dialogut ndërfetar

KAPITULLI V
BUXHETI PËR VITIN 2019

KSHK është një institucion qendror shtetëror dhe si i tillë, i nënshtrohet ligjeve në fuqi për administratën publike. Duke qenë një institucion buxhetor dhe përfituar fonde nga buxhet i shtetit, ai harton politikat e tij në linjë me politikat qeveritare mbi fenë, duke i alokuar fondet përkatëse për realizimin e objektivave të prefiksuar.

Për këtë qëllim dhe në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 99, datë 03.12.2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, të gjithë komponentët e PBA 2020-2022 janë hartuar që të harmonizojnë politikat/objektivat e Komitetit Shtetëror për Kultet, me shpërndarjen buxhetore për realizimin e tyre.

❖ **ZËRAT EKONOMIKË DHE REALIZIMI I TYRE**

Në zbatim të politikës së programit “Mbështetje për Kultet Fetare” si një mjet për garantimin e një mjedisi ku, çdo bashkësi fetare, të shprehë dhe praktikojë lirisht të drejtën kushtetuese të besimit dhe duke iu përmbajtur tavaneve buxhetore të miratuara me VKM – në Nr. 731, datë 12.12.2018, është bërë shpërndarja e fondeve buxhetore sipas artikujve ekonomikë, për secilin produkt.² Përdorimi i fondeve buxhetore e detyron institucionin të zbatojë me përpikmëri ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke monitoruar vazhdimisht gjatë harkut vjetor, përputhshmërinë e shpenzimeve institucionale me shkallën e realizimit të objektivave. Treguesit e performancës janë përdorur si mjet matës i pozicionimit të KSHK –së. Në plotësimin e objektivave të pasqyruara në PBA –në e sipërpërmendur, duke përdorur me efikasitet dhe efikasitet burimet financiare dhe njerëzore, Grupi i Menaxhimit Strategjik, ka ndjekur, hap pas hapi, ecurinë e realizimit të objektivave dhe përdorimin e fondeve përkatëse të destinuara për to, duke dhënë rekomandimet e rastit, duke korigjuar dhe rialokuar fondet dhe duke ndërhyrë, në rast mangësish, për të realizuar arritjen e objektivave.


² Pasqyruar në tabelën nr. 2

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

Tabela Nr. 2


SHPENZIME PERSONELI (Lekë)	PLANI VJETOR (Mijë Lekë)	REALIZIMI VJETOR (Mijë Lekë)	PËRQINDJA (%)
Zëri ekonomik 600 (PAGAT)	10,512	10,202	97%
Zëri ekonomik 601 (SIGURIMET SHËND. dhe SHOQ.)	1,743	1,675	96%
Zëri ekonomik 602 (MALLRA dhe SHËRBIME)	7,145	3,203	45%
Zëri ekonomik 604 (TRANSFERTA me të TRETË)	109,000,000	109,000,000.000	100%
Zëri ekonomik 231 (INVESTIME)	1000	118,32	12%

Grafiku i realizimit të zërave ekonomikë 2018-2019



RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

Grafiku i realizimit në (%), të zërave ekonomikë
2018-2019



Gjatë vitit 2019 treguesit e performancës tregojnë një realizim fondesh në nivel objektiv (PBA 2020-2022) dhe nivel produkti. Nga të dhënat e grafikeve të mësipërm vihet re realizim i plotë i zërave ekonomikë 600,601 dhe 604 dhe një realizim i ulët i zërave ekonomikë 602 dhe 231, për faktorë të jashtëm, shpesh të paparashikueshëm.

Shkaqet e këtij mosrealizimi justifikohen me:

- 1) Mungesën e shpenzimeve buxhetore për udhëtimet e parashikuara jashtë vendit, të cilat, në shumicën e rasteve, janë përballuar nga palët ftuese.
- 2) Anullim i eventeve të parashikuara nga palët e ndryshme.
- 3) Ngrirje/pezullim i prokurimeve të parashikuara në muajin dhjetor, sidomos për zërin 231 (pajisje zyre), për vënien e fondeve në dispozicion të riparimit të dëmeve të konsiderueshme të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, në mjediset e KSHK.

Megjithëse, gjatë procesit të shpërndarjes së fondeve, merren gjithmonë parasysh faktorë që mund të ndikojnë në mopërdorimin e plotë të fondeve, ngjarjet e tilla natyrore duhet të na shtyjnë në një përlllogaritje më të saktë të riskut në menaxhimin financiar të vitit të ardhshëm. Theksojmë se megjithatë, institucioni ka realizuar objektivat që i kishte prefiksuar vetes për vitin 2019.

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

❖ **PROKURIMET “ME BLERJE TË VOGËL”**

Për nevojat institucionale, që të krijohen kushtet për realizimin e objektivave të KSHK – së, gjatë vitit 2019, janë realizuar një sërë prokurimesh për blerje me vlerë të vogël, të cilat i nënshtrohen dhe bëhen në zbatim të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “ Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe udhëzimeve që e shoqërojnë. Ato pasqyrohen në tabelën mëposhtë³:

Tabela Nr. 3

NR	OBJEKTI I PROKURIMIT	FONDI LIMIT	LLOJI I PROCEDURES SE PROKURIMIT	VLERA E KONTRATËS	DATA/ORA E ZHVILLIMIT TE PROC. SE PROKURIMIT	OPERATORI EKONOMIK I SHPALLUR FITUES	NIPT I OPERATORIT EKONOMIK	DATA E PUBLIKIMIT
1	ABONIMI VJETOR NE SHTYPIN VENDAS	83333.00		76410.00		"AGJENSIA E ABONIMIT TE SHTYPIT"	K31517010H	10/01/2019 02:45 PM
2	BILETA TRANSPORTI AJROR NDERKOMBETAR	400000.00	PURCHASE TICKETS	64200.00	27/03/2019 04:10 PM	AIDA TIKO	L91322051A	08/01/2019 02:44 PM
3	BLERJE KANCELARIE	100000.00		73234.00		OLSON LAMAJ	L91307016G	13/02/2019 11:19 AM
4	BLERJE KARBURANTI	587500.00	SMALL VALUE	459375.00	23/01/2019 09:30 AM	A&T	L32320008H	07/01/2019 12:22 PM
5	BLERJE KOMPJUTERASH	166666.00	SMALL VALUE	98600.00	05/11/2019 09:30 AM	BLUEPRINT TECHNOLOGIES	L82428011G	10/01/2019 01:40 PM
6	BLERJE KUTITE NDIHMES SE SHPEJTE DHE PAJISJE TE TJERA EMERGJENCE.	9584.00		9584.00		VJOLLCA LOGU	L71406037B	29/01/2019 10:20 AM
7	LARJE AUTOMJETI	33333.00		24500.00		XHOVAN GJINI	L71806046M	27/02/2019 11:23 AM
8	MATERIALE PASTRIMI	25000.00		20640.00		LUMTURI XHENGGO	K61422018E	27/02/2019 10:44 AM
9	MIREMBAJTJE/RIPARIM PAJISJE ZYRE	58333.00		45600.00		FASTECH	J81609010U	15/08/2019 01:41 PM
10	MIREMBAJTJE/RIPARIME TE AUTOMJETIT TE INSTITUCIONIT	375000.00	SMALL VALUE	100000.00	14/11/2019 12:30 PM	ERMAL OSMËNAJ	K81420038K	07/01/2019 12:22 PM
				84000.00	11/09/2019 09:00 AM	KUJTIMI 06	K61911016R	07/01/2019 12:22 PM
				87000.00	11/04/2019 09:30 AM	VOL-AL SERVICE	K91313048D	07/01/2019 12:22 PM
				14000.00	04/07/2019 10:00 AM	VOL-AL SERVICE	K91313048D	07/01/2019 12:22 PM

³ Tabela Nr. 3 e realizimit të prokurimeve me blerje të vogël.

RAPORT VJETOR I PUNËS 2019

11	PRITJE PERCJELLJE	100000.00		5000.00		IMER BERHAMI	K33709286R	28/10/2019 10:21 AM
				18750.00		EDLIRA KUCAJ	L73807004A	28/10/2019 10:21 AM
12	SHERBIME MIREMBAJTJE DHE RIPARIMI	50000.00		9584.00		VJOLLCA LOGU	L71406037B	29/01/2019 10:10 AM
13	SHERBIME PASTRIMI PER ZYRAT E KSHK-SE	250000.00	SMALL VALUE	200004.00	10/01/2019 09:30 AM	PASTRIME SILVIO	K91413010N	07/01/2019 12:22 PM
14	SIGURACION TPL DHE FULL KASKO	62500.00		46842.00		EUROSIG SHA	K41926801Ë	27/12/2019 09:56 AM
15	TONERA PER PRINTERA	100000.00		94543.00		INFOSOFT OFFICE	J62426002Q	13/02/2019 11:22 AM

REKOMANDIME

Viti 2019 ka shënuar një nivel të kënaqshëm realizimi objektivash për institucionin. Ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi i rritur, për problemet sociale, klima paqësore dhe konstruktive e bashkëpunimit midis bashkësive fetare dhe mes tyre e shtetit, në parandalimin dhe zgjidhjen e tyre, e dëshmon këtë. Megjithatë efikasiteti i KSHK duhet përmirësuar për vitin 2020 nëpërmjet rritjes së iniciativës në ndërmarrjen e veprimeve që përmbliidhen në mision ligjor të tij, në thellimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera qendrore dhe vendore dhe në zgjerimin e promovimit ndërkombëtar të harmonisë fetare në vend. Viti 2020 shënon vitin e kryesimit nga Shqipëria të OSBE dhe roli i fesë në ruajtjen e sigurisë dhe kooperimit është thelbësor. Prej këtij rrjedh një angazhim total i energjive të KSHK në bashkëpunimin me partnerët e huaj dhe organizmat që trajtojnë të drejtën për liritë fetare.